

# RAPORT I MONITORIMIT

## KONSULTIMI PUBLIK ME ORGANIZATA ANËTARE TË PLATFORMËS CIVIKOS GJATË VITIT 2016





# **RAPORT I MONITORIMIT**

---

**KONSULTIMI PUBLIK ME ORGANIZATA  
ANËTARE TË PLATFORMËS CIVIKOS  
GJATË VITIT 2016**

**Maj 2017**

**Autor:** Dardan Kryeziu – Zyrtar për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim

**Hulumtuese:** Doruntina Rexhaj

**Publikuar:** Platforma CiviKos

Prishtinë, Maj 2017

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e CIVIKOS dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

# PËRMBAJTJA

6	Lista e Akronimeve
7	Hyrje
8	Konsultimi publik me organizata anëtare të Platformës CiviKos gjatë vitit 2016
8	Pasqyrë e zbatimit të Programit Legjislativ nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe organizimi i konsultimit publik
11	Rezultatet e Hulumtimit rreth pjesëmarrjes së organizatave anëtare në CiviKos në procesin e konsultimit publik gjatë vitit 2016
11	Rezultatet e Hulumtimit
13	Disa nga perceptimet e organizatave të shoqërisë civile që janë përgjigjur në pyetësor sa i përket procesit të konsultimit publik me Qeverinë e Kosovës
13	Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik
15	SHTOJCA 1 Projektligjet e Miratuara në Qeveri dhe konsultuara përmes CiviKos gjatë vitit 2016

# LISTA E AKRONIMEVE

<b>CiviKos</b>	Platforma CiviKos
<b>OSHC</b>	Organizatë e Shoqërisë Civile
<b>KCSF</b>	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
<b>IKS</b>	Iniciativa Kosovare për Stabilitet
<b>ZQM/KM</b>	Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit
<b>ZL/ZKM</b>	Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit
<b>Dokumente qeveritare</b>	Projektligjet, Udhëzimet Administrative, Projekt-Rregulloret, Strategjitë
<b>Strategjia Qeveritare</b>	Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017
<b>Këshilli</b>	Këshilli për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile
<b>Rregullore</b>	Rregullorja për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik.

## HYRJE

Edhe gjatë vitit 2016 CiviKos ka lehtësuar pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë në procesin e konsultimit publik. Format më të shpeshta të pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile në këtë proces edhe gjatë këtij viti kanë qenë përmes ftesave për kontribute me shkrim në dokumente qeveritare, si dhe ftesave për debate publike.

Përfshirja e shoqërisë civile qysh në fazat më të hershme të hartimit të dokumenteve qeveritare ka qenë më e rrallë, ku organizatat e shoqërisë civile kryesisht kanë qenë të përfshira në mënyrë individuale, pa rregulla të caktuara gjithëpërfshirëse. Ky raport është një pasqyrë e organizimit të konsultimit publik që Qeveria e Kosovës e ka organizuar përmes CiviKos-it gjatë vitit 2016. Përveç përmbledhjes së realizimit të agjendës legjislative nga ana e qeverisë për vitin 2016, dhe organizimit të konsultimit publik, CiviKos ka realizuar edhe një hulumtim. Ky hulumtim është realizuar me organizata anëtare të CiviKos për të parë se sa aktive kanë qenë në procesin e konsultimit publik gjatë vitit 2016, dhe cilat janë përvojat e tyre në këtë proces.

Gjatë vitit 2016 Qeveria e Republikës së Kosovës përmes CiviKos ka dërguar për konsultim publik gjithsej **137 dokumente qeveritare**. Në Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së

Kosovës gjatë vitit 2016 kanë qenë të parapara për plotësim ndryshim **112 Projektligje**<sup>1</sup>. Gjatë vitit 2016 vetëm **53 projektligje** janë miratuar në Qeveri<sup>2</sup>. Nga **53 projektligjet** e miratuara vetëm **27** prej tyre janë dërguar në konsultim publik përmes Sekretariatit të Platformës CiviKos.

Përveç organizimit të konsultimit publik përmes ftesave për kontribute me shkrim, Sekretariati i Platformës CiviKos ka lehtësuar pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në grupe punuese duke avokuar dhe promovuar përfshirjen e shoqërisë civile qysh në fazat e para të hartimit të dokumenteve qeveritare. Hartimi dhe miratimi i Standardeve Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, mbetet një shembull i mirë i përfshirjes së shoqërisë civile qysh në fazat e para të hartimit të politikave qeveritare. Hyrja në fuqi e Rregullores për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit publik fuqizon pjesëmarrjen e shoqërisë civile, dhe qytetarëve në procesin e konsultimit publik . Kjo Rregullore është miratuar në Prill 2016<sup>3</sup> dhe ka hyrë plotësisht në fuqi nga 1 Janari 2017. Pas aprovimit të Rregullores është lëshuar në përdorim edhe platforma online <http://konsultimet.rks-gov.net/> e cila platformë do të jetë mjeti kryesor i organizimit të konsultimit publik.

<sup>1</sup> [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROGRAMI\\_LEGJISLATIV\\_PER\\_VITIN\\_2016\\_perditesuar\\_me\\_09\\_12.2016.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROGRAMI_LEGJISLATIV_PER_VITIN_2016_perditesuar_me_09_12.2016.pdf)

<sup>2</sup> [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Raport\\_Vjeter\\_i\\_Punes\\_se\\_Qeverise\\_per\\_vitin\\_2016\\_final.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Raport_Vjeter_i_Punes_se_Qeverise_per_vitin_2016_final.pdf)

<sup>3</sup> [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Regullore\\_QRK\\_Nr.\\_052016\\_per\\_standardet\\_minimale\\_per\\_procesin\\_e\\_konsultimit\\_public.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Regullore_QRK_Nr._052016_per_standardet_minimale_per_procesin_e_konsultimit_public.pdf)

## Konsultimi publik me organizata anëtare të CiviKos gjatë vitit 2016

CiviKos gjatë vitit 2016 ka përcjellë tek organizatat anëtare, dhe ato jo anëtare përmes 5 Qendrave Regjionale të Kosovës **137 dokumente qeveritare** të pranura për konsultim publik nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përveç konsultimit me shkrim shpesh herë ministrinë kanë dërguar ftesa për pjesëmarrje në debate publike si dhe kërkesa për përfshirje të organizatave të shoqërisë civile në grupe të ndryshme punuese. Lehtësimin e pjesëmarrjes

së pjesëtarëve të shoqërisë civile në këto grupe CiviKos e ka bërë në mënyre transparente sipas Rregullores së Punës të CiviKos.


Ky raport i monitorimit është një përmbledhje e organizimit të konsultimit publik që Qeveria e Kosovës ka realizuar përmes të CiviKos-it, dhe nuk e përfshinë organizimin e konsultimit publik që Qeveria e Kosovës, dhe ministrinë e linjës kanë realizuar me organizata të shoqërisë civile në mënyrë individuale.

## Pasqyrë e zbatimit të Programit Legjislativ nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe organizimi i konsultimit publik.

Grafikonët më poshtë paraqesin realizimin e Agjendës Legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2016, si dhe organizimin e konsultimit publik përmes CiviKos-it. Po ashtu re-

zultatet më poshtë paraqesin edhe llojin e dokumenteve qeveritare që janë aprovuar në qeveri, dhe konsultuar përmes CiviKos-it gjatë vitit 2016.


### Konsultimi publik 2016 - Agjenda Legjislative e Qeverisë së Republikës së Kosovës



Gjatë vitit 2016 gjithsej 137 dokumente qeveritare janë dërguar për konsultim publik tek CiviKos. Në Agjendën Legjislative të Qeverisë së Kosovës kanë qenë të parapara për plotësim ndryshim gjithsej 112 projektligje. Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2016 ka miratuar 53 projektligje. Nga 53 projektligje të miratuara vetëm 29 prej tyre janë dërguar për konsultim publik tek CiviKos-it.




## Udhëzime administrative të miratuara dhe konsultuara me CiviKos 2016



Sa i përket Udhëzimeve Administrative, në raportet e punës së Qeverisë nuk ka një numër të saktë se sa Udhëzime Administrative kanë qenë në plotësim ndryshim gjatë vitit 2016. Nga hulumtimi i web faqeve të ministrive të linjës janë identifikuar 61 Udhëzime Administrative<sup>4</sup> të miratuara gjatë vitit 2016. Vetëm 23 Udhëzime Administrative janë dërguar për konsultim publik përmes CiviKos-it.

## Konsultimi publik 2016 - përdorimi i gjuhëve zyrtare dhe respektimi i afatit kohor




Duke u bazuar në faktin se dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës janë shqip dhe serbisht Sekretariati i Platformës CiviKos ka bërë përpjekje të vazhdueshme për tu kujdesur që të gjitha projektligjet që vijnë në konsultim publik nga Qeveria e Kosovës të jenë në dy gjuhë.

Nga gjithsej 137 dokumente qeveritare që janë dërguar për konsultim tek CiviKos, 4 prej tyre nuk janë dërguar në dy gjuhë zyrtare edhe pas intervenimit të CiviKos ndërsa, vetëm 3 dokumente janë dërguar në dy gjuhët zyrtare pas intervenimit të CiviKos.

Nga gjithsej 137 dokumenteve qeveritare të konsultuara me CiviKos, për 8 nga këto dokumenteve qeveritare nuk është respektuar afati 15 ditësh edhe pas intervenimit të CiviKos, ndërsa për 4 dokumente qeveritare është zgatur afati pas intervenimit të CiviKos.


<sup>4</sup> Ky numër nuk paraqet domosdoshmërisht numrin e saktë të Udhëzimeve Administrative të miratuara në Qeveri gjatë vitit 2016, pasi është numër i nxjerrë nga web faqet e ministrive të linjës të cilat kanë qenë të publikuara, dhe të verifikueshme se janë aprovuar gjatë vitit 2016

### Dokumentet qeveritare të konsultuara me CiviKos gjatë vitit 2016




Nga 137 dokumente qeveritare të shpërndara për konsultim publik gjatë vitit 2016, 36 kanë qenë Projektligje, 51 Udhëzime Administrative, 24 Projekt - Rregullore, 15 Koncept Dokumente, 10 Strategji, 1 dokument tjetër.

### Koncept Dokumentet e miratuara në Qeveri dhe konsultuara përmes CiviKos - 2016



Sa i përket Koncept Dokumenteve të planifikuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për vitin 2016<sup>5</sup> nga 69 ,vetëm 26 prej këtyre janë miratuar në Qeveri në vitin 2016, ndërsa vetëm 7 prej këtyre koncept dokumenteve të miratuara janë dërguar për konsultim publik me CiviKos.

### Strategjitë e miratuara në Qeveri dhe konsultuara përmes CiviKos- 2016



Nga gjithsej 41 Dokumente Strategjike të planifikuara për hartim në vitin 2016<sup>6</sup>, 8 prej tyre janë miratuar në Qeveri ndërsa vetëm 2 prej këtyre dokumenteve strategjike janë dërguar për konsultim publik tek CiviKos.

<sup>5</sup> [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Raport\\_Vjetor\\_i\\_Punes\\_se\\_Qeverise\\_per\\_vitin\\_2016\\_final.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Raport_Vjetor_i_Punes_se_Qeverise_per_vitin_2016_final.pdf)

<sup>6</sup> [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Raport\\_Vjetor\\_i\\_Punes\\_se\\_Qeverise\\_per\\_vitin\\_2016\\_final.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Raport_Vjetor_i_Punes_se_Qeverise_per_vitin_2016_final.pdf)


## Rezultatet e Hulumtimit rreth pjesëmarrjes së organizatave anëtare në CiviKos në procesin e konsultimit publik gjatë vitit 2016

Përveç monitorimit të rregullt të organizimit të procesit të konsultimit publik Sekretariati i Platformës CiviKos ka dërguar një pyetësor tek të gjitha organizatat anëtare për të matur perceptimin e tyre rreth pjesëmarrjes në procesin e konsultimit publik me qeverinë, si dhe për të parë përvojat dhe vështirësitë në këtë proces.

Një pyetësor i përbërë prej 10 pyetjeve është shpërndarë përmes platformës *google drive* tek të gjitha organizatat anëtare të CiviKos ku 24 organizata i janë përgjigjur pyetësorit.

### Rezultatet e Hulumtimit


#### 1. A keni marrë pjesë në procesin e konsultimit publik gjatë vitit 2016?



Në pyetjen se: **A keni marrë pjesë në procesin e konsultimit publik gjatë vitit 2016?**

Nga 24 pjesëmarrës, 16 ose 67% janë përgjigjur **Po** kam marrë pjesë, ndërsa 8 ose 33% janë përgjigjur **Jo** nuk kam marrë pjesë.


#### 2. (nëse jo përgjigjuni vetëm në këtë pyetje) - Nëse nuk keni marrë asnjëherë pjesë në procesin e konsultimit publik gjatë vitit 2016 cila ka qenë arsyeja ?



Në pyetjen se: **Nëse nuk keni marrë asnjëherë pjesë në procesin e konsultimit publik gjatë vitit 2016 cila ka qenë arsyeja?**

Nga 14 pjesëmarrës sa janë përgjigjur **6 ose 43%** janë përgjigjur se **nuk kanë mundur të marrin pjesë për shkak të mungesës së kohës**, **3 ose 22%** janë përgjigjur se kanë mungesë të ekspertizës, **3 ose 22%** janë përgjigjur se **Mendoj që kontributi im nuk merret parasysh**, si dhe **2 ose 14 %** pjesës së mbetur janë përgjigjur me **arsye tjera**.


### 3. (Nëse PO) Në çfarë forme keni kontribuar në procesin e konsultimit publik ?



Në pyetjen se: **Nëse keni kontribuar në procesin e konsultimit publik, në çfarë forme keni kontribuar në procesin e konsultimit publik?**

**1** responent (**6**) % ka deklaruar se ka qenë pjesë e grupit punues nga fillimi i draftimit, **3 ose 19** % janë përgjigjur se kam dërguar komente me shkrim përmes email, **7 ose 44**% janë përgjigjur se Kam dhënë kontributin përmes debateve publike, **4 ose 25**% janë përgjigjur Të gjitha me lartë, dhe **6**% janë përgjigjur dicka tjetër.


### 4. Sa është marrë parasysh kontributi juaj?



Në pyetjen se: **Sa është marrë parasysh kontributi juaj?**

**2 ose 11**% janë përgjigjur Plotësisht, **10 ose 56**% janë përgjigjur Pjesërisht, **1 ose 5**% janë përgjigjur Aspak, ndërsa **3 ose 17**% janë përgjigjur Nuk e di, dhe **11**% janë përgjigjur me tjera arsye tjera.

### 5. (Nëse keni dërguar kontribute me shkrim) A keni pranuar përgjigje nga zyrtaret përgjegjës për përfshirjen ose jo të kontributeve tuaja?



Në pyetjen se: **A keni pranuar përgjigje nga zyrtaret përgjegjës për përfshirjen ose jo të kontributeve tuaja?**

**2 ose 12**% janë përgjigjur me Po gjithmonë, **6 ose 37**% janë përgjigjur Vetëm në disa raste, **6 ose 38**% janë përgjigjur Asnjëherë, dhe **2 ose 13**% nuk kanë dhënë përgjigje.

## **Disa nga perceptimet e organizatave të shoqërisë civile që janë përgjigjur në pyetësor sa i përket procesit të konsultimit publik me Qeverinë e Kosovës**

- *Në përgjithësi kemi kontribuar në disa dokumente qeveritare në procesin konsultimit publik mirëpo mungon përgjigja e zyrtarëve përgjegjës rreth asaj se nëse kontributi që e kemi dërguar është inkorporuar ose nuk është inkorporuar në draft.*
- *Kemi kërkuar disa herë që të përfshihemi në draftim të legjislacionit në grupe punuese pasi aty mund të japim kontributin më të madh por nuk kemi marrë asnjë përgjigje rreth pjesëmarrjes.*
- *Komentet tona në Strategjinë e Kulturës janë marrë parasysh dhe ka pas konsultim kryesisht të kënaqshëm.*
- *Disa nga komentet që i kemi dërguar si organizatë minoritare janë inkorporuar në Strategjinë për Integrimin e komunitetit RAE.*

## **Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik**

Vendosja e Standardeve Minimale për procesin e konsultimit publik ka qenë një proces i paraparë me Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017. Në Prill të vitit 2016 është miratuar Rregullorja për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik. Kjo Rregullore është bazuar tek dokumenti i përgatitur nga organizata KCSF, ku përmes Këshillit i është dorëzuar Zyrës së Kryeministrit. Rregullorja është hartuar me një pjesëmarrje të gjerë të shoqërisë

civile dhe akterëve tjerë. Pas miratimit të Rregullores, kanë filluar edhe trajnimet për nëpunës civil rreth përdorimit të Rregullores. Mekanizmi kryesor i zbatimit të kësaj Rregullore është edhe Platforma online për procesin e konsultimit publik <http://konsultimet.rks-gov.net/> e cila pritet të funksionalizohet gjatë vitit 2017 ku të gjitha dokumentet qeveritare për konsultim publik do të vendosen në këtë platformë.



## SHTOJCA 1

### Projektligjet e Miratuara në Qeveri dhe konsultuara përmes CiviKos gjatë vitit 2016

	PROJEKTLIGJET E MIRATUARA NË QEVERI 2016	- DATA E MIRATIMIT NE QEVERI DHE NR. VENDIMIT	- ORGANI PROPOZUES I PROJEKTLIGJIT	ORGANIZUAR KONSULTIM PUBLIK PËRMES CIVIKOS
1	Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-237 dhe me Ligjin Nr.05/L-068	Nr.07/71	MF	JO
2	Projektligji për Mbrojtjen nga Zhurma	Nr.02/72, 29.01.2016	MMPH	JO
3	Projektligji për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961).	Nr. 02/79, 15.03.2016	MPJ	JO
4	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L -033 si dhe Ligjin nr. 04/L-115.	Nr.No.Br.13/81	MD	PO
5	Projektligji për Akademinë e Drejtësisë	Nr.No.Br.01/82, 30.03.2016	MD	PO
6	Projektligji për Parandalimin e Pastrimit të parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.	Nr. 02/85	MF	PO
7	Projektligji për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Komunitet të Kosovës që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011.	Nr. 03/86, 29.04.2016	ZKM	PO
8	Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10.	Nr.05/86	MF	JO
9	Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Rehabilitimin e Rrugëve Rajonale.	Nr. 04/86, 29.04.2016	MF	JO
10	Projektligji për ndihmën shtetërore	Nr. 02/89, 25.05.2016	MF	PO

11	Projektligji për performancën energjetike në ndërtesa.	Nr. 01/89	MMPH	PO
12	Projektligji për mbrojtjen e fëmijës.	Nr. 01/88, 20.05.2016	ZKM	PO
13	Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.	Nr. 01/91. 08.06.2016	MPJ	JO
14	Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Hua Ndërmjet KFW Frankfurt Am Main Dhe Qeverisë Së Republikës së Kosovës për Programin “Masat e Eficiencës së Energjisë në Ndërtesat Publike në Nivel Komunal në Kosovë”	Nr..04/92, 10.06.2016	MF	JO
15	Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të Modernizimit të Shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës	Nr. 01/94, 15.06.2016	MF	JO
16	Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërkom-bëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë.	Nr. 01/95, 16.06.2016	ZKM	JO
17	Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjeve në Republikën e Kosovës.	Nr. 02/95, 16.06.2016	ZKM	JO
18	Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal.	Nr. 01/96, 22.06.2016	MF	JO
19	Projektligji për Plotësimin dhe ndryshimin e ligjit Nr.05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.	Nr.No.Br.01/99, 01.07.2016	MF	JO
20	Projektligji për Ratifikimin e Memeorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, Kosovë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës Programi Fulbright i Shkëmbimit Akademik.	Nr. 01/100, 15.07.2016	MASHT	JO
21	Projektligji për Kamatëvonesat në Transaksionet Tregtare	Nr. 02/100, 15.07.2016	MTI	PO



22	Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës evropiane për rindërtim dhe zhvillim për projektin e trafikut urban.	Nr. 03/100, 15.07.2016	MF	JO
23	Projektligji për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.	Nr. 02/101, 22.07.2016	MASHT	PO
24	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe ligjin nr. 04/L-168.	Nr. 02/104, 10.08.2016	MF	PO
25	Projektligji për Akreditim	Nr.02/107, 31.08.2016	MTI	PO
26	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-139 Për procedurën përbarimore.	Nr..01/108, 08.09.2016	MD	JO
27	Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L - 043 për Faljen e Borxheve Publike.	Nr..01/109, 16.09.2016	MF	PO
28	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë.	Nr..02/110, 30.09.2016	ZKM	JO
29	Projektligji për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.	Nr. 03/110, 30.09.2016	MF	PO
30	Projektligji për Trepçën.	Nr. 02/111, 05.10.2016	MZHE	JO
31	Projektligji për Inspektoratin Shëndetësor.	Nr. 01/112, 18.10.2016	MSH	PO
32	Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.	Nr. 02/113, 31.10.2016	MF	JO
33	Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.	Nr..04/113, 31.10.2016	MIE	JO
34	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit nr. 04/L-123 të procedurës penale.	Nr.03/113, 31.10.2016	MD	JO
35	Projektligji për Shërbime	Nr. 01/116, 16.11.2016	MTI	PO
36	Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.	Nr. 02/116, 16.11.2016	MD	PO

37	Projektligji për Legalizimin e Armëve dhe Dorëzimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive.	Nr. 02/117, 23.11.2016	MPB	PO
38	Projektligji për Automjete	Nr. 03/117	MI	PO
		23.11.2016		
39	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës.	Nr.02/118, 30.11.2016	ZKM	JO
40	Projektligji për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës.	Nr.No.Br.01/119, 07.12.2016	MMPH	PO
41	Projektligji për ndërmjetësim	Nr.02/119, 07.12.2016	MD	PO
42	Projektligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.	Nr. 03/120, 14.12.2016	MD	PO
43	Projektligji për Ndërmarrjet Sociale	Nr.02/120, 14.12.2016	MPMS	PO
44	Projekt Kodi i Drejtësisë për të Mitur	Nr. 02/121, 21.12.2016	MD	JO
45	Projektligjit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore	Nr..01/122, 23.12.2016	ZKM	JO
46	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214.	Nr. 02/122, 23.12.2016	MPB	JO
47	Projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës	29.12.2016	MPMS	JO
48	Projektligji për Pagat		MAP	PO
		30.12.2016		
49	Projektligji për Noterinë	30.12.2016	MD	PO
50	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-004/26 për Trashëgiminë e Kosovës	30.12.2016	MD	PO
51	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jo-kontestimore	30.12.2016	MD	PO

52	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.	30.12.2016	MF	PO
53	Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bahkëpunimin Rinor në mes të Kosovës, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë	30.12.2016	MKRS	JO

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK  
**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
Swiss Cooperation Office Kosovo

---

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).